

1. Informacion Bazë

- Viti i Themelimit: 1991
- Statusi Ligjor: Organizatë joqeveritare
- Selia Qendrore: Rruga Janos Hunyadi, G.32, Ap.11 Tiranë, Albania
- Faqja e Internetit: <https://ppnea.org>
- Email kryesor i organizatës: contact@ppnea.org
- Telefoni kryesor i organizatës: [04 562 8954](tel:045628954)

2. Misioni

Misioni i organizatës sonë është të garantojë një klimë qeverisëse dhe shoqërore ku ruajtja e trashëgimisë natyrore të jetë prioritare, nëpërmjet kërkimit shkencor rigoroz, përfshirjes së komunitetit, krijimit të partneriteteve strategjike dhe ndërveprimit të vazhdueshëm me institucionet vendimmarrëse.

3. Vizioni (Opsionale)

Të sjellim harmoni midis natyrës dhe shoqërisë njerëzore!

4. Fushat Kryesore të Fokosit

- Ruajtja dhe mbrojtja e llojeve me rëndësi, të rralla e të rrezikuara;
- Ruajtja dhe mbrojtja e zonave me vlera të larta të biodiversitetit;
- Studimi i jetës së egër dhe habitateve;
- Edukimi, ndërgjegjësimi dhe advokimi për çështjet e ruajtjes dhe mbrojtjes së natyrës;
- Zhvillimi institucional i organizatave mjedisore të shoqërisë civile.

5. Aktivitetet/Programet Kryesore

- Paving the Way towards the Implementation of CCAs in Albania through Enhancement of Governance and Management of PAs
Projekti synon të vendosë një qasje pilote për Korridoret Ekologjike (CCA) në zonën Cukal-Munellë-Balgaj-Martanesh përmes ndërtimit të kapaciteteve, zhvillimit të një modeli qeverisës, kërkimit shkencor, monitorimit dhe restaurimit të habitateve, duke siguruar zbatimin në kohë dhe me efikasitet nga të gjithë partnerët e projektit
- Balkan Lynx Recovery Programme 2.0
Projekti synon përmirësimin e kushteve të habitatit, mbrojtjes ligjore dhe mbështetjes nga publiku.
- PrespaNet III - To protect Prespa Lakes waters and wildlife key species, through conducting research and monitoring, as well as in the Prespa-Ohrid-Shebenik eco region

Projekti synon të përmirësojë ruajtjen e ujvrave dhe qëndrueshmërinë ndaj ndryshimeve klimatike në rajonin e Prespës përmes restaurimit ekologjik, përfshirjes së aktorëve lokalë, bashkëpunimit ndërkufitar, monitorimit mjedisor dhe angazhimit të vazhdueshëm të komunitetit.

- **Protecting Vjosa's Delta from unsustainable urban development: an integrated approach for the long term conservation of biodiversity values in the lower Vjosa valley**
Projekti synon të krijojë njohuri për deltën e Vjosës, të llojë kundër ndërtimit të aeroportit për të mbrojtur Peizazhin e Mbrojtur Vjosa-Nartë, të mobilizojë kundërshtimin publik ndaj urbanizimit dhe të ruajë e restaurojë popullatat e shpendëve dhe habitatet e tyre.
- **Sustainable Future for Sharr/Korab-Koritnik**
Projekti synon të mbështesë zhvillimin e qëndrueshëm rajonal përmes përfshirjes së komuniteteve lokale, uljes së kërcënimeve ndaj biodiversitetit, përmirësimit të habitateve, forcimit të bashkëpunimit ndërkufitar dhe shkëmbimit të njohurive, si dhe rritjes së dukshmërisë së zonës ndërkufitare.

6. Shtrirja Gjeografike

PPNEA operon në një shtrirje të gjerë gjeografike në nivel kombëtar, për shkak të projekteve të cilat implementohen në pjesë të ndryshme të Shqipërisë. Fokusi në ruajtjen e jetës së egër dhe habitateve ku ato jetojnë bën që puna kërkojë më shumë të zhvillohet në terren, kryesisht në zona të mbrojtura nga veriu i Shqipërisë e deri në Jug. Zonat kryesore në fokus: Parku Natyror Muntë, Parku Natyror Korab-Koritnik, Parku Kombëtar Shebenik, Peizazhi i Mbrojtur Vjosë – Nartë, Parku Kombëtar Detar Karaburun – Sazan, Parku Kombëtar i Prespës, Parku Kombëtar Divjakë - Karavasta Lumi Buna – Velipojë etj.

7. Udhëheqja

Drejtori Ekzekutiv/CEO: Aleksandër Trajçe

Bordit i Drejtuesve: Arjola Mesiti, Enerit Saçdanaku, Erjola Keçi, Kujtim Mersini, Alba Brojka, Roland Lleshi, Spartak Koçi

8. Partneritetet dhe Bashkëpunimet (Opsionale)

Bird Life partner, PONT, Euronatur, HBS Tirana, CEPF, The Prince Albert II of Monaco Foundation

9. Ndikimi (Opsionale)

Fushata Albania is Biodiversity pranë sheshit Skënderbej

<https://ppnea.org/portfolio-item/24615/>

- 10,000+ Vizitorë
- 1M njerëz u informuan nëpërmjet social media
- 920 nxënës ndoqën programin e edukimit
- 200 vullnetarë të regjistruar

10. Lajmet e Fundit/Çmimet (Opsionale)

Fluturime testuese në kantierin e Aeroportit të Vlorës – Një shfaqje e madhe elektorale

<https://ppnea.org/deklarate-per-shtyp-nga-euronatur-dhe-ppnea/>